

RELACION

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 179, DATË 26.2.2020 “PËR RREGULLAT, KUSHTET DHE PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANESAVE QË KANË QENË SUBJEKT I LIGJIT NR. 7652, DATË 23.12.1992, “PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE” DHE TË LIGJIT NR. 9321, DATË 25.11.2004 “PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË KTHYERA NË BANESA, TË NDËRTUARA ME FONDET E SHOQËRIVE DHE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Propozimi dhe kërkesa për miratimin e këtij ndryshimi ka si qëllim zgjatjen e afatit kohor sa i takon procedurave të privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është në përputhje të plotë me ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”, dhe programin politik të Këshillit të Ministrave për sa i përket politikës ekonomiko-sociale të shtetit shqiptar.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Kërkohej ndërmarrja e iniciativës ligjore për miratimin e këtij ndryshimi ligjor, konkretisht për shtyrjen e afatit, pasi vendimi i Këshillit të Ministrave në fuqi është miratuar në shkurt të vitit 2020, vit i cili kishte një situatë të ndërlikuar me pandeminë covid-19 dhe ndërkohë pika 31 e këtij vendimi ka parashikuar se “Privatizimi sipas këtij vendimi, ka afat deri në 2 vjet nga hyrja në fuqi e tij”. Pra, periudha 2-vjeçare rezulton e pamjaftueshme për të përfunduar procedurat e privatizimit për kategoritë e përcaktuara në këtë vendim Ky shqetësim është ngritur nga Enti Kombëtar i Banesave dhe nga Bashkia Shkodër, ku kërkohej shtyrja e këtij afati kohor në interes të qytetarëve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 118 të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”.

Relacion shpjegues për “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.453, datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”.

- a. *Përputhshmëria e aktit të propozuar me nenin 100, pikën 1 dhe pikën 2 të nenit 118 të Kushtetutës: Akti i propozuar propozohet nga organi kushtetues si Ministri i Financave dhe Ekonomisë, dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, i cili ka tagrin të miratojë këtë akt. Bazuar në nenin 77 të ligjit 22/2018, jemi në kushtet e plotësimit të kërkesave kushtetuese të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës për nxjerrjen e akteve nënligjore për arsye se: (i) ligji material përcakton organin publik i cili ka tagrin të urdhërojë nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor (Këshilli i Ministrave), (ii) ligji i cili shërben si bazë ligjore e aktit të propozuar autorizon në mënyrë të shprehur nxjerrjen e aktit nënligjor (iii) ligji parashikon çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të cilave nxirret akti i propozuar. *Përputhshmëria e aktit të propozuar me qëllimin e dispozitës përkatëse të ligjit, në funksion të propozimit: Ligji për strehimin social ka të përcaktuara qartë edhe modalitetet që duhet të plotësojë akti sa i takon qëllimit të propozimit.**
- b. Bazuar në këtë parashikim të ligjit, ministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, propozon aktin përpara organit që ligji ka autorizuar, Këshillit të Ministrave.
- c. Përputhshmëria e aktit me legjislacionin ndërkombëtar: Akti nuk lidhet drejtëpërdrejtë me ndonjë akt ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka si objektiv të përafrohet me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi propozohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, me qëllim shtyrjen e afatit dhe vijimin e procedurave të privatizimit në interes të qytetarëve.

Projektakti ndryshon vetëm pikën 31 të vendimit në fuqi, duke sjellur një reformulim konkretisht:

“31. Privatizimi i banesave sipas këtij vendimi, ka afat 2 (dy) vite pas daljes së certifikatës së pronësisë të përcaktuar në pikën 6 të vendimit.

Pika dy parashikon se ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, Enti Kombëtar i Banesave dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Relacion shpjegues për “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.453, datë 03.07.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”.

Ky projektvendim u hartua nga Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE).

**VIII RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
BUXHETORE**

Projektvendimi nuk sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTRI PROPOZUES

**MINISTËR I FINANCAVE
DHE
EKONOMISË**

Delina IBRAHIMAJ

Relacion shpjegues për "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.453, datë 03.07.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti".